



Prishtinë: 20.11.2011

Kodi i ZRRE-së: V_389_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_687_11_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_687_11_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2011 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Shpresa Bekteshi ("Jeta Garazh Publike" – parashtruesi i ankesës Sabit Bunjaku, shifra në KEK: DPR - 90044343) nga Prishtina bazuar në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 25.05.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.05.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 09.12.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se pika matëse është e djegur plotësisht si dhe TMRR-të. Ekipi i kontrollës së KEK-ut po ashtu ka evidentuar se konsumatori shkyçet nga rrjeti elektrik.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 093212 i datës 09.12.2009
- Me datë 16.12.2009 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë KEK-ut për ndërrim si dhe kontroll të grupit matës.
Provë: Aplikacioni për ndërrim dhe kontrollim të grupit matës i datës 16.12.2009
- Me datë 26.02.2010 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë KEK-ut për ndërrim si dhe kontroll të grupit matës.
Provë: Aplikacioni për ndërrim dhe kontrollim të grupit matës i datës 26.02.2010
- Me datë 11.03.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me kërkesë të konsumatorit kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se grupi matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 35581009 është i djegur tërësisht si dhe e kanë larguar nga matja ndërsa kanë vendosur për matje grupin matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 3000061.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 006396 i datës 11.03.2010
- Me datë 11.03.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë larguar nga matja grupin matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 3000061, ndërsa kanë vendosur për matje grupin matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 96256196 me qëllim të leximit nga distanca.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 006397 i datës 11.03.2010



- Me datë 13.01.2010 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR10HP08157 në vlerë prej 535.13 €. **Provë:** Fatura DPR10HP08157 e datës 13.01.2010
- Me datë 07.05.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 12.05.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës. **Provë:** Përgjigjia e KEK-ut e datës 12.05.2010
- Me datë 25.05.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Me datë 09.12.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se pika matëse është e djegur plotësisht si dhe TMRR-të. Ekipi i kontrollës po ashtu ka evidentuar se energjia e shpenzuar nga konsumatori nuk regjistrohet dhe si pasojë e mos regjistrimit të energjisë së shpenzuar konsumatori shkyçet nga rrjeti elektrik. **Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 093212 datë 09.12.2009
- ✓ Bazuar në procesverbalet e leximit nr. 006245 konstatohet se me datë 29.10.2009 ekipi i KEK-ut i autorizuar për leximin e pikave matëse ka konstatuar gjendjen reale të shpenzimeve duke mos evidentuar asnjë parregullsi. Me datë 01.12.2009 ekipi i KEK-ut i autorizuar për leximin e pikave matëse ka përpiluar procesverbalin nr. 006831 dhe ka konstatuar se njehsori elektrik është i djegur, faza "S" së bashku me transformatorët rrymorë e djegur plotësisht dhe se njehsori mbetet nën tension. **Provë:** Protokollet e leximit nr. 006245 datë 29.10.2009 dhe nr. 006831 i datës 01.12.2009
- ✓ Me datë 16.12.2009 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë KEK-ut për ndërrim si dhe kontroll të grupit matës dhe se të njëjtën kërkesë e ka përsëritur edhe me datë 26.02.2010. **Provë:** Aplikacioni për ndërrim dhe kontrollim të grupit matës, e datës 16.12.2009 dhe 26.02.2010
- ✓ Me datë 11.03.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me kërkesë të konsumatorit kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se grupi matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 35581009 është i djegur tërësisht si dhe e kanë larguar nga matja njehsorin elektrik. Punëtorët e KEK-ut me atë datë kanë vendosur për matje grupin matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 3000061. Në të njëjtën ditë punëtorët e KEK-ut kanë larguar nga matja grupin matës (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 3000061, ndërsa kanë vendosur për matje grupin matës (KEK) (njehsori aktiv dhe reaktiv) nr. 96256196 me qëllim të leximit nga distanca. **Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 006396 datë 11.03.2010 dhe nr. 006397 i datës 11.03.2010
- ✓ DMK ka analizuar proceset e leximit të KEK-ut si dhe procesverbalet e inspektimit të përpiluara nga ekipet e autorizuar të KEK-ut dhe kanë vërejtur se KEK-u ka nga data 01.12.2009 ka evidentuar se njehsori elektrik ka qenë i djegur, faza S e djegur me transformator, por që kanë theksuar se njehsori mbetet nën tension. Punëtorët e KEK-ut gjatë inspektimit të pikës matëse me datë 09.12.2009 kanë evidentuar se pika matëse e konsumatorit është e djegur bashkë me TMRR dhe se energjia e shpenzuar nuk matet. Duhet theksuar se gjatë këtij procesverbali punëtorët e KEK-ut kanë shkyçur nga rrjeti elektrik.



Punëtorët e KEK-ut me datë 31.12.2009 gjatë procesverbalit të leximit nr. 008800 kanë evidentuar se njehsori elektrik tërësisht i djegur dhe se nuk ka mundësi të lexohet. Në procesverbalin e leximit nr. 008800 punëtorët e KEK-ut nuk kanë evidentuar se a është i shkyçur konsumatori apo jo.

- ✓ Sipas këtyre proceseve të leximit dhe procesverbaleve të inspektimit të pikave matëse vërehet se pika matëse e konsumatorit ka qenë e shkyçur nga rrjeti elektrik nga data 09.12.2009 dhe se inspektimi i fundit (Protokolli mbi leximin e GM) para konstatimit të djegies së pikës matëse është bërë me datë 29.10.2009 kur edhe është konstatuar se pika matëse është në rregull. KEK-u edhe përkundër evidentimit të vet punëtorëve të KEK-ut se pika matëse është djegur dhe kërkesës së konsumatorit për ndërrim njehsori të bërë me datë 16.12.2009 nuk ka marrë asnjë masë për të bërë ndërrimin e atij grupi matës deri në kërkesën e dytë të konsumatorit të bërë me datë 26.02.2010.
- ✓ Sipas transaksioneve të konsumatorit për shifrën DPR – 90044343 vërehet se mesatarja e faturave të energjisë elektrike ka qenë: 2007 – 229 €; 2008 – 231 €; 2009 – 135 €; 2010 – 210 €; 2011 – 215 €. Sipas analizave të bëra faturave të energjisë elektrike vërehet se mesatarja e faturave të energjisë prej 05/2007 e deri te periudha e inspektimit (09.12.2009) ka qenë 207.35 €, ndërsa mesatarja e faturave të energjisë elektrike prej pas periudhës së inspektimit e deri te periudha 10/2011 është 233.46 €. Sipas kësaj vërehet se nuk ka ndonjë ndryshim të faturave të energjisë elektrike para inspektimit dhe pas inspektimit.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- ✓ DMK ka dërguar shkresë zyrtare në KEK për të rishqyrtimin e lëndës së konsumatorit duke i kërkuar KEK-ut që të analizohen mirë procesverbalet e KEK-ut dhe duke kërkuar një shpjegim më detal se si ka ardhur deri te djegia e grupit matës. KEK-u edhe përkundër shkresës së DMK, nuk ka rishqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim shtesë lidhur me lëndën e konsumatorit.
Provë: Shkresa e DMK e datës 14.06.2010
- ✓ DMK bazuar në analizën e bërë llogaritjes së faturës së rikthimit të humbjeve të përpiluar nga departamenti i faturimit në KEK konstaton se KEK-u ka respektuar Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike por ka ngarkuar konsumatorin për periudhën dy mujore.
Provë: Fatura DPR10HP08157 e datës 13.01.2010
- ✓ Konsumatori në deklaratën e tij thekson se dëmtimin e njehsorit e ka lajmëruar menjëherë punëtori i NP"Jeta" dhe se e njëjta mund të vërtetohet me procesverbalin e KEK – ut nr. 093212 datë 09.12.2009 të përpiluar me rastin e inspektimit pas kërkesës sonë.
Provë: Ankesa e konsumatorit
- ✓ KEK-u në lëndën e konsumatorit nuk ka bërë ndonjë analizë të lëndës së konsumatorit apo të proceseve tjera të leximit, por konsumatorin e ka ngarkuar vetëm sipas konstatimeve të bëra sipas procesit të kontrollës nr. 093212 të datës 09.12.2009.

DMK duke marrë parasysh argumentet dhe analizat e bëra ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **aprovohet pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se:

1. KEK sha duhet të shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08157 në vlerë prej 535.13 €.
2. KEK sha duhet të ngarkoj konsumatorin me faturë duke marrë për bazë pajisjet të cilat janë evidentuar në procesverbalin e kontrollës së KEK nr. 093212 të datës 09.12.2009 dhe atë vetëm për një muaj (muaji 11/2009).



Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovjë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK sha duhet të shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08157 në vlerë prej 535.13 €.
2. KEK sha duhet të ngarkoj konsumatorin me faturë duke marrë për bazë pajisjet të cilat janë evidentuar në procesverbalin e kontrollës së KEK nr. 093212 të datës 09.12.2009 dhe atë vetëm për një muaj (muaji 11/2009).

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar